



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
OIK

REPublika e Kosovës - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO		
Oda e infirmierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës Komora medicinskih sestara, babica i ostalih zdravstvenih stručnjaka Kosova Chamber of nurses, midwives and other health professionals of Kosovo		
ARKIV ARHIV ARCHIVE		
Nr. Prot. Broj prot. Prot. №	Nr. i faq. Br. str. №. pag.	Data Datum Date
586	-1-	20.07.2021

Oda e infirmierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës
Komora medicinskih sestara, babica i ostalih zdravstvenih stručnjaka Kosova
The Kosovo Chamber of nurses, midwives and other health professionals

Mbështetur në Vendimin e Këshillit Drejtues 05.07.2021 Kryetari i OIK shpallë:

FTESË PUBLIKE PËR AUDITIMIN E JASHTËM FINANCIARË TË OIK-UT

Ftojme kompanite audituese te licencuar nga Keshilli i Kosovës per Raportim Financiar (KKRF), qe te paraqesin ofertat e tyre per: **Auditimin e pasqyrave financiare te Odës së Infirmierëve të Kosovës për vitin 2019-2020.**

Objektivat dhe fushëveprimi i punës:

Qëllimi i auditimit të veprimtarisë së OIK-ut është që të mundësojë auditorin të shprehë një opinion profesional mbi pozicionin financiar dhe të ardhurave e shpenzimeve për periudhën kontabël. Auditimi do të kryhet në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) të publikuara nga Bordi i Standarteve Ndërkombëtare të Auditimit dhe Sigurisë të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (IFAC). Këto standarte kërkojnë që auditori të planfikojë dhe kryejë auditimin për të marrë siguri të arsyshme në lidhje me atë nëse pasqyrat financiare nuk janë të pavërteta. Auditimi përfshin shqyrtimin, në bazë të testimit, të provave që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare. Kjo gjithashtu përfshin vlerësimin e parimeve të përdorura të kontabilitetit dhe vlerësimeve të rëndësishme të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të përgjithshëm të pasqyrave financiare.

Ofertat e paraqitura duhet të përmbajnë:

- Auditori duhet të jetë një kompani ligjore dhe kredibile e auditimit;
- Auditori duhet të jetë krejtësisht i paanshëm dhe i pavarur;
- Përvojat në auditimin e institucioneve të tjera të ngjashme me OIK;
- CV- të dhe referencat për stafin dhe përvojat e tyre dhe
- Ofertën financiare

Përzgjedhja e auditorit të pavarur bëhet nga Këshilli Drejtues të OIK-ut, pas mbylljes së afatit për aplikim.

Dokumentacioni i kompletuar dorëzohet pranë zyrave të OIK-ut në formë fizike nga ora 09:00 deri në ora 14:00.

Afati i aplikimit është 5 ditë pune nga dita e publikimit në webfaqen e OIK-ut, <http://oik-ks.org/>.

Data e publikimit:
30.07.2021



Kryetari i OIK-ut
Naser Rrustemaj